



# Republika e Kosovës

## Republika Kosova - Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim  
Agencija Kosova za Akreditaciju  
Kosovo Accreditation Agency



Data: 15.07.2016

Ref.: 651/16

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.02/2013, datë 16.01.2013), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë, në mbledhjen e 43-të, të mbajtur më 06 Korrik 2016, mori:

### V E N D I M

I. Riakreditohen programet e studimit të BPrAL Kolegji “AAB” për periudhën pesë vjeçare, 1 tetor 2016 – 30 shtator 2021:

- Banka dhe Financa, MSc, 120 ECTS, (maksimumi 100 student për vit akademik);
- Administratë Publike dhe Diplomaci, MA, 120 ECTS (maksimum 120 student për vit akademik);
- Shkenca Kompjuterike, BSc, 180 ECTS (me specializime: Inxhinieri Softverike; Telekomit dhe Rrjetat Kompjuterike; Mekatronika), (maksimum 200 student për vit akademik);
- Shkenca Kompjuterike, MSc, 120 ECTS, (maksimum 40 student për vit akademik);
- Muzikologji, BA, 240 ECTS (me specializime: Muzikologji; Teori Muzikore; Teknologji Muzikore), (maksimum 60 student për vit akademik);
- Dizajn Enterier, BA, 180 ECTS, (maksimum 30 student për vit akademik);
- Piktura dhe Artet Vizuele, BA, 180 ECTS (maksimum 40 student për vit akademik);
- Komunikim Masiv, BA, 180 ECTS (me specializime: Gazetari; Produksion) (maksimum 90 student për vit akademik);
- Komunikim Masiv - Gazetari, MA, 120 ECTS, (maksimumi 40 student për vit akademik);
- Gjuhë Angleze, BA, 180 ECTS, (me specializime: I përgjithshëm; Përkthim) (maksimum 500 student për vit akademik në Prishtinë, 200 në Ferizaj, dhe 100 në Gjakovë);
- Gjuhë Angleze, MA, 120 ECTS (Gjuhe dhe Letërsi Angleze; Përkthim dhe Interpretim (maksimum 250 student për vit akademik);

II. Riakreditoohen programet e studimit për periudhën tre vjeçare 1 tetor 2016 – 30 shtator 2019:

- Juridik, LLB, 240 ECTS, (me specializim: Kriminalistikë), (maksimumi 450 student për vit akademik në Prishtinë, 200 në Ferizaj, 150 në Gjakovë);
- Psikologji, BA, 180 ECTS (maksimum 200 student për vit akademik);
- Kulture Fizike dhe Sport, BA, 240 ECTS, (maksimum 200 student për vit akademik);
- Kulture Fizike dhe Sport, MA, 60 ECTS, (maksimum 70 student për vit akademik);
- Politikat Sociale dhe Mirëqenia e Fëmijëve, MA, 120 ECTS (maksimum 150 student për vit akademik);
- Menaxhment dhe Informatikë, MA (120 ECTS) (maksimum 250 student për vit akademik);

III. Akreditoohen programet e studimit për periudhën tre vjeçare, 1 tetor 2016 – 30 shtator 2019:

- Dizajn Grafik, MA, 120 ECTS (maksimumi 30 student për vit akademik)
- Psikologji Organizative dhe Sociale, MA, 120 ECTS (maksimumi 60 student për vit akademik);

IV. Nuk riakreditohet programi i studimit:

- Juridik – Civil, LLM, 60 ECTS

V. Aprovohet kërkesa e BPrAL Kolegji “AAB” nr.249/16, datë 04.05.2016 për plotësimin e programit të studimit: Përkujdesje dhe Mirëqenia e Fëmijëve /BA (180 ECTS), në Përkujdesje dhe Mirëqenia e Fëmijëve, BA (240 ECTS).

VI. Kuotat e caktuar më sipër për regjistrim e studentëve në programet e studimit, vlejné nga viti akademik 2017/2018.

VII. Obligohet BPrAL Kolegji “AAB” që deri me 1 tetor 2016 në Agjencinë e Kosovës për Akreditim ta dorëzoj planin e rekrutimit të stafit akademik, për vitin akademik 2016/2017, për arsyeje të pensionimit të mundshëm të stafit, apo për çfarëdo arsyeje tjetër.

VIII. Obligohet BPrAL Kolegji “AAB” që deri me datë 1 tetor 2016 të dorëzoj në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA) Planin e Implementimit të

Rekomandimeve të dhëna në raportin final të ekspertëve ndërkombëtar të akreditimit.

## A r s y e t i m i

BPrAL Kolegji "AAB" ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA), për riakreditim dhe akreditim të programeve të studimit me stafin akademik si në vijim:

Nr.	Programi i studimit	Niveli	ECTS	Bartësit e Programit
1	Banka dhe Financa	MSc	120	Jusuf Fejza, Gezim Selimi, Nijazi Bytyqi
2	Juridik	LLB	240	Lulzim Tafa, Vjosa Shala, Agni Aliu
3	Psikologji	BA	180	Mimoza Shahini, Aferdita Ahmeti, Tahir Latifi
4	Psikologji Organizative dhe Sociale	MA	120	Merita Shala, Myqereme Rusi, Sunaj Raimi
5	Administratë Publike dhe Diplomaci	MA	120	Dashnim Ismajli, Arben Qirezi, Xhemazie Ibrahim
6	Komunikim Masiv	BA	180	Hasan Salihu, Bujar Tafa, Ramë Buja
7	Komunikim Masiv - Gazetari	MA	120	Arsim Sinani, Aurora Ndrio, Shaip Bytyqi
8	Kulture Fizike dhe Sport	BA	240	Fatmir Pireva, Fadil Rexhepi, Mimoza Shkodra
9	Kulture Fizike dhe Sport	MA	60	Nazim Myrtaj, Arben Maliqi, Blerim Sylejmani
10	Gjuhe Angleze	BA	180	Marika Butskhrikidze, Mirvan Xhemajli, Vjollca Dibra
11	Gjuhe Angleze	MA	120	Qatip Arifi, Vlora Ejupi, Teuta Vinca
12	Shkenca Kompjuterike	BSc	180	Ermir Rugova, Salem Lepaja, Florinda Imeri
13	Shkenca Kompjuterike	MSc	120	Arianit Maraj, Mentor Hamiti, Veland Ramadani
14	Politikat Sociale dhe Mirëqenia e Fëmijëve	MA	120	Rrustem Buzhala, Rifat Haxhijaj, Xhevat Sylja
15	Muzikologji,	BA	240	Elizabeta Musliu, Driton Bejtullahu, Kushtrim Jakupi
16	Piktura dhe Artet Vizuele	BA	180	Alban Muja, Fitim Aliu, Musa Kalaveshi
17	Dizajn Enterier	BA	180	Nysret Jusufi, Gazmend Vokshi, Armend Fazliu
18	Juridik - Civil	LLM	60	Muhamet Kelmendi, Asllan Bilalli, Mursel Bilalli
19	Menaxhment dhe Informatikë	MA	120	Florije Miftari, Bislim Lekiqi, Bajram Fejzullahu

20	Dizajn Grafik	MA	120	Faton Kurti, Agon Nimani, Besim Mikollovci
----	---------------	----	-----	--

AKA ka organizuar dy vizita në BPrAL Kolegji "AAB". Vizita e parë është realizuar më 26.04.2016, me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Prof. Dr. Peter Parycek; Prof. Dr. Milan Pol; Prof. Dr. Robert Masten; Prof. Dr. Harald Tschan; MSc. Rebecca Maxwell Stuart. Vizita e dytë është realizuar me 16.05.2016 me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Prof. Dr. Miha Škerlavaj; Prof. Dr. Peeter Normak; Prof. Dr. Thomas Bauer; Prof. Alan Brickwood; Prof. Stroud Cornock; Prof. Dr. Karmen Pizorn.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e mbajtur më 06 Korrik 2016 ka vlerësuar aplikacionin e BPrAL Kolegji "AAB", dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve të akreditimit gjatë realizimit të vizitës, dhe në rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportin final nga ekspertët e cekur më sipër, KSHC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Në lidhje me programin e studimit Juridik Civil/ LLM (60 ECTS), raporti i ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit, numëron këto vërejtje kryesore të cilat kanë quar në mos dhënien e rekomandimit për akreditim:

Sipas ekspertëve ndërkombëtarë, problemi kryesor është hartimi i programit dhe përzgjedhja e lëndëve, të cilat çojnë në dyfishime masive të përmbajtjeve me programin e studimit në nivelin Bachelor. Përshkrimi i lëndëve, metodologjia dhe literatura është shumë e njëjtë. Sipas ekspertëve nuk ka program të krahasueshëm evropian apo ndërkombëtarë i cili do të ofronte 16 ECTS për fushën civile, 9 ECTS për procedurën civile, 12 ECTS për të drejtën civile ndërkombëtare apo 10 ECTS për të drejtën kontraktuale. Këto ligjërata në këto fusha veçse mësohen në programin Bachelor në detaje prandaj sipas ekspertëve nevojitet një ridizajnim i plotë i programit, qoftë ridizajnim i programit Bachelor për fushat e së drejtës civile, qoftë një strukturë komplet e re e programit Master në Juridik Civil.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi mund të paraqitet kërkesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 126, pika 2 a, të Ligjit mbi Procedurën Administrative nr. 02/L-28. Kërkesa për rishqyrtim të vendimit i dorëzohet këtij organi në afatin prej 30 ditëve siç është përcaktuar në nenin 130, pika 1 e Ligjit mbi Procedurën Administrative.

Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Vendimi iu dërgohet:

- BPrAL Kolegji "AAB"
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.

---

Prof. Asoc. Dr. Blerim Rexha  
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë